

### ❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tillë si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkontinentale e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshmërit ekonomik të vendit.

### ❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Menaxher Kategorie COIN

### ❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Menaxheri i Kategorise eshte perjegjes per te menaxhuar dhe koordinuar punet ne katet e percaktuara per shitjen e produkteve te qendres Coin.

### ❖ DETYRAT KRYESORE

- Realizon objektivat e percaktuara nga kompania per shitjet;
- Permireson treguesit tregtare permes sherbimit cilesor ndaj klientit;
- Pergatit analiza, raporte dhe paraqet propozime per ecurine e shitjeve apo fushatave te ndryshme promocionale;
- Pergatit draft-buxhetin per departamentin qe ka nen varesi, per sezonet e reja te produkteve te kompanise dhe e paraqet ate per diskutim tek nivelet me te larta te menaxhimit;
- Merr pjesë në mbledhjet periodike që organizohen nga perjegjesi i sektorit te shitjeve per raportimin dhe ecurine e objektivave, detyrave te lena.
- Menaxhon stafin nen varesi duke planifikuar dhe propozuar nevoja per burime njerezore, duke vleresuar performancen ne pune, duke organizuar punen, planifikimin e lejeve vjetore, nevojave per trajnim, etj;
- Trajnon stafin e ri dhe ekzistues;
- Menaxhon situata problematike ne lidhje me sherbimin korrekt te klientit;
- Merr pjese ne show-room, programe trajnimi, si dhe workshopet te ndryshme te organizuara per fushen nen varesi;
- Kontrollon periodikisht gjendjen e stokut dhe kujdeset per ecurine e shitjeve;
- Analizon dhe interpretion te dhena nga shitjet me qellim per te lehtesuar procesin e planifikimit per ecurine e kompanise;
- Garanton zbatimin e standardeve me te mira ne sherbimin ndaj klienteve;
- Sugjeron aktivite promovuese per produkte dhe sezone te vecanta per te nxitur levizjen e stokut;
- Merr pjese aktive dhe drejtton stafin nen varesi, lidhur me procedurat dhe rezultatet e inventarit te organizuar sipas nevojave te kompanise;
- Ndjek funksionimin e perditshem te punes ne kat (rregullsine e uniformave te stafit, te ambientit, ndarjen e turneve/diteve te pushimit, zbatimin e orarit te punes, etj) si dhe njofton per cdo problem qe mund te ndodhe ne katin per te cilin eshte perjegjes dhe te marre masat perkatese ne rastet e nevojshme;
- Mban stafin te informuar per mbarevajtjen e aktivitetave, iniciativave te reja si dhe merr sugjerimet e tyre per ceshqte te ngjashme;
- Koordinon grupin e punes per eksposimin e koleksionit te ri dhe ndryshimet ne produktet ekzistuese me sektorin visual duke ju permbytjatur kalendarit te koleksioneve te sezoneve perkatese.
- Te qendroje i azhornuar me tendencat e tregut (sektorit qe perfaqeson).

## ❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Universitet i Ekonomise. Preferohet Menaxhim Biznesi ose Marketing

Gjuhe te huaja: Anglisht, Italisht

Njohuri kompjuterike: Msc Office, njohuri ne programe te kases

Eksperiencia e kerkuar: Mbi 3 vjet ne fushen e shitjeve. Eksperiencia te ngjashme menaxhimi ne qendra biznesi tregtare

Te gjithe te interesuarit, jane te latur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 30 Janar 2022, ora 17:00.**

\* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.